



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

KML.nr.12/2021

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Valdete Daka, kryetare, Mejreme Memaj e Agim Maliqi, anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional Bujar Balaj, procesmbajtës, në çështjen kundërvajtëse kundër të pandehurit Z.(A.) B., nga fshati Ll., komuna e I., për shkak të kundërvajtjes, nga neni 53 pika 4 lidhur me nenin 120 par.1 dhe nenin 252 par.2 të Ligjit nr.05/L-088 “Për rregullat e trafikut rrugor”, duke vendosur përkitazi me kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë të të pandehurit, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës Ka.nr.389/2021 datë 16 shtator 2021, në seancën e kolegjit të mbajtur më 30 nëntor 2021, morri këtë:

A K T V E N D I M

Hedhet si e palejueshme kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e të pandehurit Z. (A.) B., e paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës Ka.nr.389/2021 datë 16 shtator 2021.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Pejë - Dega në Istog - Departamenti i përgjithshëm - Divizioni i Kundërvajtjes, me aktgjykimin K.nr.52/2021 e datës 16 korrik 2021 të pandehurin Z.B., e ka shpallur përgjegjës për kundërvajtjen, nga neni 53 pika 4 lidhur me nenin 120 par.1 dhe nenin 252 par.2 të Ligjit nr.05/L-088 “Për rregullat e trafikut rrugor”, për të cilën i ka shqiptuar dënimin me gjobë në shumën prej 200 (dyqind) €, të cilin është obliguar ta paguaj në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, e nëse i pandehuri nuk e bën pagesën e gjobës e njëjta do të ekzekutohet me dhunë në kuptim të nenit 163 pika 4 të Ligjit për kundërvajtje. Ndaj të pandehurit është shqiptuar edhe masa mbrojtëse ndalimi i drejtimit të automjetit me veprim motorik të kategorisë B në kohëzgjatje prej një (1) viti, si dhe 5 pikë negative, e cila masë do të ekzekutohet në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit. I dëmtuari për realizimin e kërkesës pasurore juridike është udhëzuar në kontest civil. Me të njëjtin aktgjykim i pandehuri L.F., është liruar nga përgjegjësia për shkak të kundërvajtjes, nga neni 128.1.2 të Ligjit për kundërvajtje sepse nuk është provuar se i njëjti e ka kryer atë.

Në procedurën ankimore Gjykata e Apelit e Kosovës, me aktgjykimin Ka.nr.389/2021 e datës 16.09.2021 e ka hedh poshtë ankesën e të pandehurit Z.B., dhe refuzuar si të pabazuar atë të njësisë rajonale të komunikacionit rrugor në Pejë, kurse aktgjykimin e shkallë së parë e ka vërtetuar.

Kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë ka ushtruar i pandehuri Z.B., për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kundërvajtëse, nga neni 135 par.5 të ligjit nr.05/L-087, me propozim që Gjykata Supreme e Kosovës të aprovoj kërkesën aktgjykimi i kundërshtuar të anulohet dhe çështja ti kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim apo të ndryshohet sa i përket dënimit.

Kryeprokurori i Shtetit të Kosovës, me parashtrësën me shkrim KMLK.nr.19/2021 e datës 19 nëntor 2021 ka propozuar që kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e të pandehurit të hedhet si e palejuar.

Gjykata Supreme e Kosovës, në kuptim të nenit 431 par.1 dhe par.6 të KPPK, i shqyrtoi shkresat e lëndës dhe gjeti se:

-kërkesa është e palejueshme.

Sipas dispozitës së nenit 149 par.1 të Ligjit për Kundërvajtje (nr.05/L-087), i cili ka hyr në fuqi në janar të vitit 2017, kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë mund të ngritët kundër aktgjykimit të formës së prerë për kundërvajtjen me të cilin është shkelur ligji ose dispozita tjetër për kundërvajtjen. Mirëpo, sipas par.2 të nenit të lartcekur kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë e ngritë prokurori i shtetit brenda afatit prej 3 (tre) muajsh nga data kur aktgjykimi për kundërvajtjen ka marrë formën e prerë.

Nga kjo dispozitë del se i pandehuri nuk ka të drejtë të paraqes kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë, ngase kjo e drejtë i takon vetëm Prokurorit të Shtetit, që do të thotë se në rastin konkret kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e të pandehurit me ligj nuk është e lejuar.

Nga sa u tha më lartë e në bazë të nenit 435 par.2 të KPPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - PRISHTINË
KML.nr.12/2021, më 30 nëntor 2021

Procesmbajtësi,
Bujar Balaj

Kryetarja e kolegjit,
Valdete Daka